

VENDIM
Nr.421, datë 2.7.2004

**PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE NGA PRIVATIZIMI I “ARMO”
SHA, FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.9117, datë 24.7.2003 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të “Armo” sh.a., Fier”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ardhurat, që realizohen nga privatizimi i “Armo” sh.a., Fier të përdoren si më poshtë vijon:

a) Deri në 10 për qind të përdoren nga Ministria e Ekonomisë, për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e shitjes së aksioneve dhe për pagesën e tarifës së suksesit shoqërisë këshilluese, sipas kontratës së lidhur me të.

b) Pjesa tjetër të derdhet në Buxhetin e Shtetit.

2. Struktura e këtyre pagesave të parashikohet në ligjin për Buxhetin e Shtetit, për vitin pasardhës.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë të paraqesë, pas përfundimit të procesit të shitjes, raportin financiar për përdorimin e këtyre të ardhurave.

4. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano